



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË

Nr. 6052 / prot.

Tiranë, më 01.11.2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 864, datë 02.06.2005.

SHOQËRISË “LOSHI BL” SH.P.K
Qukës-Shkumbin, Lagjja Nr. 1, Rruga Nacionale, Banesë private , Librazhd

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “LOSHI BL” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.864, datë 02.06.2005, për mineralin krom, në Objektin “Varri i Plakës-Përroi i Qukut”, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 3557, datë 18.07.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 6052 Prot., datë 19.07.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.864, datë 02.06.2005, për mineralin krom, në Objektin “Varri i Plakës-Përroi i Qukut”, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan pasi në objektin mineralar nuk ushtrohet aktivitet prej më shumë se një viti dhe subjekti nuk ka të miratuar planin vjetor të punës për vitin 2023-2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Mineralar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 864, datë 02.06.2005, për mineralin krom, në Objektivin "Varri i Plakës-Përroi i Qukut", Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 864, datë 02.06.2005, për mineralin krom, në Objektivin "Varri i Plakës-Përroi i Qukut", Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRI**

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

CENO KLOSI

